

FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

Ujësjetës Kanalizime Durrës Sh.a

Durrës, 06/09/2018

“Rikonstruksion i ujesjellesit sektori Qëndër,njesia administrative Sukth,Bashkia Durres”

Për: **“ KUPA” sh.p.k** Nipt K51615512C me adresë: Rruga “ Berisha “, Argjinaura
Nr.pasurie 482 Çekrezë - Kamëz Tiranë.

Proçedura e prokurimit: “Proçedurë e hapur-pune”

Numri i references se procedures/lotit: **NR REF-76603-06-27-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës:

Objekti: **“Rikonstruksion i ujesjellesit sektori Qëndër,njesia administrative
Sukth,Bashkia Durres”**

- Fondi limit: **69.834.088,33** (Gjashtedhjetë e nente milion e teteqind e tridhjetë e kater mije e tetedhjetë e tete presje tridhjetë e tre leke) lekë pa TVSH.
- Burimi i te ardhurave: Te ardhurat e U.K.D Sh.a
- Kohezgjatja e kontrates: **120 ditë nga lidhja e kontratës**
- Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në proçedure 2(dy) Operatorë Ekonomik si me poshte:

1. **“Lala” shpk** Nipt J76418903B dhe **“Shansi Invest” shpk** Nipti: J61924002T
2. **“ KUPA ” shpk** Nipt K51615512C

Operatori ekonomik **“Lala” shpk dhe “Shansi Invest” shpk** është skualifikuar për arsye se nuk përmbush:

1. Kriteret e veçanta të kualifikimit

Pikën 1.c

- Në përlllogaritjen e çmimit për njesi me sasinë ka gabime aritmetike, gje që reflekton në vlerat nëntotale si dhe në shumën totale te ofertës.

2. Kapaciteti teknik

Pika 4.1:

- Drejtuesi teknik Kajtaj Rataj me profesion inxhinier Gjeodet nuk ka kontratë dhe nuk figuron në listpagesë. Kontrata me inxhinierin gjeodet është në emër të Kajtas Alikaj i cili nuk ndodhet në licencën e shoqërisë.

Pika 4.2:

- Nuk ka sjelle Certifikatën e trajnimit për Sigurinë dhe Mbrojtjen e Shendetit në Punë

Pika 4.5:

- Kontrata e punës për mekanikun Festim Aga ka nuk është e vlefshme për periudhën e realizimit të kontratës

Pika 5:

- Kontrata e qerasë së mjeteve me nr.1597 Rep. Nr.616 Kol. me ‘‘Jody’’ shpk nuk është vlefshme për periudhën e zbatimit të kontratës
- Trancheri me vakum i deklaruar nuk është sipas kriterëve të DST

Pika 8:

- OE nuk është paraqitur me datë 20.07.2018 ora 12:00 pranë shoqërisë UKD për të bërë vizitën në terren së bashku me stafin teknik të UKD me qëllim njohjen e kushteve të ekzekutimit në terren të objektit. Mosparaqitja e OE përbënte kusht për skualifikim sipas kriterëve të DST.

Pra kualifikohet Operatori Ekonomik: ‘‘ KUPA’’ sh.p.k me vlerë të ofruar:

- **pa TVSH është 66.628.713,9 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e trembëdhjetë presje nëntë) lekë.**
- **me TVSH është 79.954.456,68 (shtatëdhjetë e nëntë milion e nëntëqind e pesëdhjetë e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e gjashtë presje gjashëdhjetë e tetë) lekë.**

Duke ju referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ‘‘ KUPA’’ sh.p.k se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej: **66.628.713,9 (gjashtëdhjetë e gjashtë milion e gjashtëqind e njëzet e tetë mijë e shtatëqind e trembëdhjetë presje nëntë) lekë** pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Ujesjelles Kanalizime Durrës sh.a sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 30 ditëve nga dita e

marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë: 27/08/2018

Gjatë afatit ligjor prej 7 ditësh për pritjen e ankesave nuk pati ankesa.

